



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI UNIVERSITAR “SHEFQET NDROQI”
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE JURIDIKE, PROKURIMEVE DHE BURIMEVE NJERËZORE

Nr. _____ Prot.,

Tiranë më, 14.12.2023.

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje lëndë djegëse për ngrohje, pellet në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me afat 12 muaj nga lidhja e MK”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave është: Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: **Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: 64,889,034 (gjashtëdhjetë e katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, e konvertuar në Euro: 103.01, sipas kursit të këmbimit të datës 14.12.2023: 629,930 (gjashtëqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë) Euro pa TVSH.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Lëndë druri: 03419000-0

Nr.	OBJEKTI	NJESIA	Sasia E Pritshme
1	Lëndë djegëse për ngrohje - Pellet	kg.	778,980

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor **Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Përcaktimi për vlerën e pritshme të mallrave është bërë referuar Udhëzimit nr. 6 datë 16.01.2018 “Për përdorimin e MK dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 15,

protokolluar në APP me nr. 10418 prot., datë 26.11.2018, në të cilën në pikën 7 përcaktohet: “7. Përlllogaritja e vlerës së marrëveshjes kuadër

7.1 Vlera e parashikuar e një marrëveshje kuadër duhet të përfshijë shumën e përlllogaritur të të gjitha vlerave të kontratave, që parashikohen të jepen gjatë kohës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

7.3. Fondi limit, me të cilin autoriteti kontraktor do të shpallë procedurën e prokurimit është vlera e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër. Hartimi i kriterëve të veçanta për kualifikim, si kapacitetet teknike ekonomike apo kritere të tjera, të cilat lidhen me fondin do të përlllogariten mbi vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen.”

Në zbatim të nenit 42, pika 2, të VKM 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.*”, do të donim të argumentonim se: Kjo procedurë nuk është ndarë në lote pasi po prokurohen dy artikuj të së njëjtës natyrë (mirëmbajtje të pajisjeve mjekësore) dhe me të njëjtën firmë prodhuese (Siemens/ose ekuivalent), si rrjedhim ndarja në lote nuk zgjeron konkurrencën apo anasjelltas, mosndarja në lote nuk pegon konkurrencën e lirë të ofertojë.

AK ka vendosur të mos realizojë ndarjen me lote sepse kemi vetëm një artikull, objekt Prokurimi. Gjithashtu, nisur edhe nga historiku i të gjithë këtyre vite të prokurimit të këtij objekti, nuk është bërë në asnjë moment ndarja në lote.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kriteri 2.1.1.: Operatori Ekonomik duhet të jete i pajisur Leje mjedisore të tipit B (me kod III.1.B) Veprimtaritë e lëndës drurit dhe produkteve të përbëra siç është pelleti së bashku me akt miratimin përkatës e cila lidhet me objektin e prokurimit.

Kriteri 2.1.2.: Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të kategorisë III.2.B Grumbullim, transportim, përpunim i mbetjeve të lëndës drusore si dhe liçensën profesionale përkatëse.

Argumentimi për kriterin 2.1.1 dhe kriterin 2.1.2: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në bazë të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 5, germa a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në mbështetje të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjit nr.10448, datë 14.07.2011, “On. lejet mjedisore” i ndryshuar, Ligji nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 538, date 26.05.2009, ”Per licensat dhe lejet, qe trajtohen nga/apo nepermjet QKB dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” e ndryshuar,

Këto kritere janë vendosur nga Komisioni Ad-hoc i AK-së për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike, me qëllim që të ketë ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi krijuar nga autoritetet shtetërore, përta i përket detyrimeve dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi, për tregtimin me të njëjtin objekt Prokurimi.

Gjithashtu, sipas argumetimit të Komisionit Ad-hoc: Këto Kritere janë vendosur në zbatim të legjislacionit të prokurimeve, si edhe për pasjen që të ketë ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim mbrojtjen e mjedisit.

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kriteri 2.2.1: Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020, 2021 dhe 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **vlera e pritshme e kontratave të kësaj Proçedure Prokurimi.**

Shënim*: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas vlerës së pritshme të të kësaj proçedure prokurimi, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në pikën 2.10 /ose/ 2.14.

Nëse operatorët ekonomikë, në këtë proçedurë prokurimi, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këtë DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj proçedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ne perputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne të cilin gjejmë të përcaktuar se:

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Legjislatori në pikën 1 dhe pikën 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Proçedurën e Hapur, ku përcaktohet se:

Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

Pika2/: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;* Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare për të permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Referuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure AK ka menduar se vendosja e nje vlere minimale te xhiros jo me e vogel se **vlera e pritshme e kontratave / vlerës së fondit limit***, për të cilë konkurron operatori, është një dëshmi e mjaftueshme për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomikë ofertues zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhës.*

Vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2022, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë patur afat deri më 31.03.2022.

(Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 "Mbi Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

Kriteri 2.2.2 : Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020-2021-2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe rekomandimeve të Kllsh.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

1.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

Kriteri 2.3.1.: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit/vlerës së pritshme të Kontratave dhe **që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë **vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes,** të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm **fatura tatimore të shitjes,** të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku **shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera 20 % do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit/vlerën e prishtme të Kontratave për të cilen ofertohehet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin

e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit te lotit /apo shumatores se loteve qe oferton, vlere e cila është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë dhe është ne perputhje me percaktimet e RRPP neni 40 pika 4:

“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Eshtë kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën **minimumi 20% të fondit limit/(vlerës së pritshme të kontratave) që oferton operatori**, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Kriteri 2.3.2: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **minimalisht 2 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Gjithashtu, në zbatim të Nenit 40, pika 5/b VKM 285/2021, në fazën e provimit të vërtetësisë së deklarimeve të Shtojcës, për këtë kriter, operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e personelit kryesor dhe një CV të personelit pjesë e zbatimit të këtij objekti Prokurimi.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Më konkretisht, në nenin 40, pika 5/b dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, përcaktohet:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Personeli i Operatorit ekonomik i nevojitet Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar realizimin e plotë të objektit të këtij prokurimi.

(Shënim - Specifikoni proceset, veprimtaritë apo shërbimet që kërkohen për realizimin e kontratës së furnizimit të mallrave, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer).

Gjithashtu, argumentimi i Komisionit Ad-Hoc: Eshte menduar stafi minimal prej 2 personash i nevojshëm për realizimin e prokurimit, qe minimalisht njëri te jete shofer dhe tjetri te jete punetor qe asiston ne shkarkim te peletit.

Pika 2.3.3: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

duhet të disponojë ne pronesi ose me qera një makinë transporti me vinç me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton, për transportimin e Pelletit.

- **Për automjet në pronësi:** Aktin e pronësisë së mjetit, leje qarkullimi, akt - kolaudimi dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet, si dhe foto te mjetit ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese. Automjetet e perdorura duhet qe te plotesojne karakteristikat e mjetit te nevojshme për transportimin e Pelletit.

- **Për automjetet që nuk janë në pronësi:** Kontratë qiraje të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit objekt prokurimi, si dhe leje qarkullimi, akt-kolaudim dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet, si dhe foto te mjeteve ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese. Automjetet e perdorura duhet qe te plotesojne karakteristikat e mjetit te nevojshme për transportimin e Pelletit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Më konkretisht, në nenin 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, përcaktohet:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Posedimi dhe deklarimi i mjeteve dhe pajisjeve Teknike, i nevojiten AK për të vërtetuar realizimin e plotë të objektit të këtij prokurimi. Kapaciteti mbajtës minimal 10 ton është përcaktuar nga AK pasi sillosi ynë ka kapacitet mbajtës 13 ton. Njoftimi bëhet kur sasia e Peletit është drejt fundit të ezaurimit dhe nuk lihet bosh sillosi.

(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).

Shënim: Autoriteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Kriteri 2.4.1: Për pelletin e kërkuar që paraqiten në Shtojcën 5 të DST, duhet të paraqiten mostër ditën e hapjes së ofertave, sipas Specifikimeve Teknike të Shtojcës 5, me datë **16.01.2024, në orën 10:00**. Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet pranë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, Sekretaria e S. U. "Shefqet Ndroqi", të mbyllura në një zarf /kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shenohet:

– “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit “*Blerje lëndë djegëse për ngrohje, pellet në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me afat 24 muaj nga lidhja e MK” dhe jo para datës **16.01.2024, ora 10:00**.

– Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen/përcaktohet mostra që ndodhen në zarf/kuti.

– Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr.Rendor të Artikullit që përfaqëson.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në mbështetje të kërkesës nga Komisioni i perlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, në lidhje me kriteret teknike, si dhe në përputhje me **piken 6 të nenin 40 të VKM nr.285, datë 29.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,**

{ Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose.....}

Paraqitja e mostrave për artikullin që është objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë në vend të peletit që operatori ekonomik ka dhe oferton me specifikimet teknike të percaktuara në DST në Shtojcën 5 për të bërë të mundur vlerësimin e tyre edhe me fletë-analizën përkatëse.

Argumentimi i Komisionit Ad-Hoc.: Mostra kërkohet me qëllim verifikimin fizik të artikullit për të parë cilësinë e tij, me qëllim realizimin me sukses të prokurimit.

Kriteri 2.4.2: Operatori ekonomik të paraqesë në mënyrë elektronike në sistem, fletë-analizën nga laboratorit për vlerësimin e mostrës së mallit objekt prokurimi. Fletë-analiza nuk duhet të jetë lëshuar më vonë se gjashtë muaj, nisur nga data e hapjes së ofertave.

Paraqitja e fletë-analizës për artikullin objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë në vend të mostrës së pelletit që operatori ekonomik posedon dhe oferton me specifikimet teknike të percaktuara në DST në Shtojcën 5 për të bërë të mundur vlerësimin e tyre edhe me fletë-analizën përkatëse.

Ndërkohë, afati gjashtë mujor Autoriteti Kontraktor gjykon se është mëse i mjaftueshëm për të verifikuar që Pelleti që po sillet mostër është i njëjtë me atë të analizave laboratorike, përpos verifikimeve të dokumentacionit që posedon mostra, meqenëse jemi në stinën e dimrit dhe pelleti ka një përdorim masiv në këtë periudhë.

Argumentimi i Komisioni Ad-Hoc: Përveç mostrës, është kërkuar edhe fletë-analiza, e cila ben të mundur evidentimin e përbërjes së materialit të peletit nëse është apo jo sipas specifikimeve të vendosura nga A.K. Afati 6 mujor është vendosur sipas rekomandimeve të APP-se për Procedurën e prokurimit të lëndes djegëse Peletit 2023 dhe argumentohet me faktin se: Afati 6 muaj është vendosur për faktin që edhe pse ne kërkojmë furnizime në sasi të mëdha, si edhe nëse OE do të ketë në gjendje fizike Pelet i jepet mundësia të ofertojë njëjtë si ata OE të cilët kanë tregëtim peleti më të shpejtë në kohë dhe më të shpeshtë në kohë. Me këtë synohet të zgjerohet konkurrenca në ofertim, në këtë procedurë prokurimi. Presupozohet që një O.E i suksesshem dhe potencialisht i afte për të realizuar me sukses procedure, duhet të ketë tregëtim peleti dhe rrjedhimisht likuiditet (referuar dhe kritereve të veçanta të vendosura në legjislacionin e Prokurimeve).

Kriteri 2.4.3: Operatori ekonomik Ofertues duhet të paraqesi: Autorizim prodhuesi, ose distributori i autorizuar, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë artikullin e prodhuesit i vlefshëm për periudhën e MK ose gjatë hapjes së ofertave. (te perkthyer dhe te noterizuar).

Shënim: Në rastin e autorizimeve të lëshuara nga distributorët e autorizuar, duhet të provohet me dokumente lidhja e tyre (distributorëve të autorizuar) me prodhuesin/MAH (mbajtësin e autorizimit të tregtimit).

Argumentim: Përsa i përket këtij kriteri vendosen në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (aftësia teknike), si dhe pika 3 e nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës. Afati i vlefshmërisë së autorizimit vendoset në përputhje me kohëzgjatjen e MK. Keto kërkesa dhe vecanerisht lidhja me distributorin, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës, pra të garancisë se furnizimit të mallit objekt prokurimi.

Shënim për operatorët ekonomikë:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

Gjithashtu risjellim në vëmendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për keto pika do të jete kusht skualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.

Në çdo rast, AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më lart, ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca nr. 5:

Blerje lënde djegëse për ngrohje - Pelet

Specifikimet Teknike te Peletit jane si me poshte:

- a. Vlera kalorifike: >16.5 Mj/ kg
- b. Lageshtia: 8.5 – 9.5 %
- c. Mbetja e hirit: <0.75%
- d. Gjatësia: 30-40 mm
- e. Diametri: 6-8 mm
- f. Sasia e squfurit që clirohet gjatë diegies: <0.04%
- g. Densiteti: > 650 kg/ m³
- h. Qendrueshmeria: > 98 ë - % +-1
- i. Lloji i drurit 85 % ahu dhe 15 % bredh (vetem tallash i paster jo levozhga druri)

1. Cdo operator ekonomik ofertues të sjellë mostrën e mallit, në oren e hapjes së tenderit, sipas standartit të kërkuar (me thasë 15 kg, plastik dhe hermetik, me logon e prodhuesit).

Argumentim:

Mostra kërkohet me qëllim verifikimin fizik te artikullit per te parë cilësinë e tij, me qëllim realizimin me sukses te prokurimit.

2. Furnizimi i mallit te bëhet sipas kërkeses se AK-se: me thasë big- bag 500 - 1000 kg.

3. Peshimi i mallit do te kryhet nga nje peshore e kolauduar nga Drejtoria e Metrologjise, qe do te vihete ne dispozicion nga ana e operatorit ekonomik (OE te sjellë edhe certifikaten e kolaudimit te peshores).

4. Furnizimi të bëhet në prani të komisionit të pritjes së mallit.
5. Operatori ekonomik fitues është i detyruar që mallin ta hedhë në sillosin e Peletit.
6. Gjatë furnizimit do të zbatohen detyrimisht rregullat e sigurimit teknik dhe të MSHZ.
7. Operatori ekonomik fitues duhet të sjellë furnizimin me marrjen e njoftimit nga Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme. Njoftimi bëhet 3 (tre) ditë para me telefon ose SMS.
8. Furnizimi bëhet brenda orarit zyrtar të punës, nga ora 8:00 deri në ora 16:00.
9. Kërkohe Fletë-analiza për pelletin, që nuk duhet të jetë lëshuar më vonë se gjashtë muaj, nisur nga data e hapjes së ofertave.

Argumentim:

Përveç mostrës, eshte kërkuar edhe fletë-analiza, e cila ben te mundur evidentimin e përbërjes së materialit te peletit nëse është apo jo sipas specifikimeve te vendosura nga A.K. Afati 6 mujor është vendosur sipas rekomandimeve te APP-se për Proçedurën e prokurimit te lendes djegese Peletit 2023 dhe argumentohet me faktin se: Afati 6 muaj eshte vendosur per faktin qe edhe pse ne kerkojme furnizime ne sasi te medha, si edhe nëse OE do të ketë në gjendje fizike Pelet i jepet mundësia të ofertojë njëjtë si ata OE të cilët kanë tregëtim peleti më të shpejtë në kohë dhe më të shpeshtë në kohë. Me këtë synohet të zgjerohet konkurenca në ofertim, në këtë proçedurë prokurimi. Presupozohet qe nje O.E i suksesshem dhe potencialisht i afte per te realizuar me sukses procedure, duhet te kete tregëtim peleti dhe rrjedhimisht likujditet (referuar dhe kriterëve te veçanta të vendosura ne legjislacionin e Prokurimeve).

10. OE, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 2 persona, për realizim furnizim.

Argumentim:

Eshte menduar stafi minimal prej 2 personash i nevojshëm për realizimin e prokurimit, qe minimalisht njëri te jete shofer dhe tjetri te jete punetor qe asiston ne shkarkim te peletit.

11. OE duhet të disponojë një makinë transporti me vinç, me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton, për transportimin e Pelletit, pasi kapaciteti mbajtës minimal 10 ton është përcaktuar nga AK pasi sillosi ynë ka kapacitet mbajtës 13 ton. Njoftimi bëhet kur sasia e peletit është drejt fundit të ezaurimit dhe nuk lihet bosh sillosi.

12. OE nëse nuk është vetë prodhuesi duhet të ketë autorizim të lëshuar nga prodhuesi ose nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit) ose distributori i autorizuar, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë artikullin me objekt prokurimi në vendin tonë.

Shënim: Në rastin e autorizimeve të lëshuara nga distributorët e autorizuar, duhet të provohet me dokumente lidhja e tyre (distributorëve të autorizuar) me prodhuesin/MAH (mbajtësin e autorizimit të tregtimit).

13. OE të jetë i pajisur me leje mjedisore Tipi B (III.1.B) Veprimtaritë e lëndës drurit dhe produkteve të përbëra siç është pelleti së bashku me akt miratimin përkatës e cila lidhet me objektin e prokurimit.

14. OE të jetë i pajisur me leje mjedisore të kategorisë III.2.B Grumbullim,transportim,përpunim i mbetjeve të lëndës drusore si dhe liçensën profesionale përkatëse.

Argumentim: Këto Kriteria janë vendosur në zbatim të legjislacionit të prokurimeve, si edhe për pasjen që të ketë ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim mbrojtjen e mjedisit.

Të gjitha kriteret e vendosura më lart janë në përputhje me dispozitat e legjislacionit të prokurimeve dhe janë kriteret minimale të cialt nu ke kufizojnë konkurrencën e lirë për këtë procedurë prokurimi.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Artikulli	Përshkrimi (Objekti)	Shuma (Sasia e pritshme)	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1.	Blerje lëndë djegëse për ngrohje - Pellet	778,980 kg.	Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", Tiranë	Sipas nevojave të AK gjatë të gjithë afatit 24 muaj të MK.

Afatet e lëvrimit:

Kontratat do të lidhen sipas nevojave të AK.

Sasia e mallit, objekt prokurimi do të lëvrohet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

- **Operatori ekonomik fitues duhet të sjellë furnizimin me marrjen e njoftimit nga Sektori I Shërbimeve të Përgjithshme. Njoftimi bëhet 3 (tre) ditë para me telefon ose SMS.**
- **Furnizimi bëhet brenda orarit zyrtar të punës, nga ora 8:00 deri në ora 16:00.**
- **Gjatë furnizimit do të zbatohen detyrimisht rregullat e sigurimit teknik dhe te MSHZ.**

Formulimi i specifikimeve, caktimi i sasive është kryer nga personi përgjegjës, Specialist Fushe, ndërsa përlllogaritja e fondit limit është kryer nga personi përgjegjës i fushës së ekonomisë.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP:

“38/b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT: